



Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, duke u bazuar në Statutin e QKMF – së, neni 11.7 dhe neni 12 pika 6, me qëllim të themelimit të Këshillit të Pacientëve me datë 05.08.2026 e publikon këtë:

FTESË PUBLIKE

“PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË PACIENTËVE”

Statuti i QKMF-së, përkatësisht neni 12.6, parasheh edhe themelimin e Këshillit të Pacientëve. Me qëllim të zbatimit të këtij neni, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, fton të gjithë qytetarët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij këshilli.

Këshilli i Pacientëve do të përbëhet nga 5 persona dhe do të ketë mandat 5 vjeçar.

Propozimet duhet të dorëzohen nga data 05.08.2026 deri me datë 18.08.2026, në emailin Gazmend.Bojaj@rks-gov.net, ose në zyrën e Drejtorisë së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë. Të gjitha propozimet e pranuar pas këtij afati, nuk do të merren parasysh nga komisioni.

Dokumentet e kërkuara:

1. Aplikacioni për të qenë anëtar i këshillit;
2. Kopja e Leternjoftimit;
3. Një leter motivuese pse dëshironi të jeni anëtar i këshillit.

Komuna e Klinës

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Agron BACAJ - Drejtor





Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Termat e Referencës:

Në Statutin e Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare është paraparë edhe themelimi i Këshillit të Pacientëve, si një mekanizëm formal i angazhimit të qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Për këtë qëllim, DSHMS ka hapur thirrje publike për të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës që janë të interesuar të jenë pjesë e Këshillit të Pacientëve.

Qëllimi i Këshillit të Pacientëve është që të shërbej si një mekanizëm formal për përfshirjen e pacientëve në vendimarrje në mënyrë që të punojnë së bashku me institucionet dhe stafin shëndetësor për të rritur cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe komunitetin.

Objektivat e Këshillit të Pacientëve do të jenë:

- Të përfshijë pacientët në vendimmarrje lidhur me shërbimet shëndetësore;
- Të rrisë vetëdijen e qytetarëve për shëndetin dhe të drejtat e tyre;
- Të identifikoj problemet dhe nevojat e pacientëve;
- Të forcoj besimin dhe komunikimin ndërmjet pacientëve dhe stafit shëndetësor;
- Të kontribuoj në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Fushëveprimi i këshillit të pacientëve shtrihet brenda teritorit të komunës së Klinës dhe merret me përfaqësimin e interesave dhe brengave të pacientëve brenda kësaj komune;

Antarësimi në Këshill të Pacientëve është i hapur. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, nuk janë anëtar të ndonjë partie politike, nuk ofrojnë shërbime shëndetësore ose farmaceutike dhe nuk kanë të kaluar kriminale.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

FORMA E APLIKIMIT:

EMRI: _____

MBIEMRI: _____

ADRESA: _____

DATËLINDJA: _____

SHKOLLIMI: _____

PROFESIONI: _____

KONTAKTI: _____

TEL: _____

EMAIL: _____

A KENI QENË NË TË KALUARËN:

- a) PACIENT
- b) PËRCJELLËS I PACIENTIT
- c) ASNJËRA NGA KËTO

JU LUTEM NA TREGONI SE PSE DËSHIRONI TË JENI PJESË E KËSHILLIT TË PACIENTËVE:

Nënshkrimi i aplikuesit:

Data:
